

VENDIM
Nr. 89, datë 9.6.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALB WIND ENERGY” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS NR. 53, SERIA NPM08P, “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE (PROJEKTI VISU DHE PROJEKTI TERPAN)”, TË DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s ME NR. 13, datë 28.1.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5 dhe 6 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 53, seria NPM08, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (Projekti VISU dhe projekti TERPAN)”, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 13.9.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 139, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. Extra prot., datë 23.12.2014, shoqëria “ALB Wind Energy” sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 24 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar, së fundmi me vendimin nr. 139, datë 15.11.2013.

- Mospërmbushja e pikës 4, të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vetë mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të ndërtim, instalim, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik “Projekti VISU dhe projekti TERPAN”.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., nr. 53, seria NPM08P.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti